

Drejtoria Rajonale Tiranë

No. _____ Prot.

Tirane, me ____ / ____ / 2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Shërbimi i ruajtjes dhe shoqerimit te vlerave monetare per Njësine e Kordinimit Tirane FSHU Sh.A”*

Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 76713000-5 “Shërbime roje/shërbime me roje

VLERA E FONDIT LIMIT:

70,074,825.6 (shtatedhjete milion e shtatedhjete e kater mije e teteqind e njezet e pese pike gjashte) **lekë pa TVSH.**

673,537.35 (gjashtëqind e shtatedhjete e tre mije e peseqind e tridhjetë e shtate pike tridhjetë e pese) **euro pa TVSH, (1 EU - 104.04 lekë)** referuar kursit të këmbimit ditor, **datë 21.12.2023** të Bankës së Shqipërisë.

Ndarje ne Lote - NUK KA

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane e OSSH Sh.A, , ka argumentuar mosndarjen e procedures në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Referuar **Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”**, neni 2 parashikohet shprehimisht se: *“Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

Drejtoria Rajonale Tiranë

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë,

pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, **Neni 42, pikat 1 dhe 2** të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

- 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*
- 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.*

Referuar **Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin Publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.*
- 2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.*

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në **VKM Nr. 285, datë 19.05.2021** i ndryshuar “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

- 1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë*

Drejtoria Rajonale Tiranë

procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

- 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*
- 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Theksojmë se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësiive duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb shërbimi është i së njëjtës natyrë. Në këto kushte, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur.

Legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetëm paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në

Drejtoria Rajonale Tiranë

përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik e njeh të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Pra duke parë natyrën, specifikat dhe përmasën e këtij shërbimi, mënyrën e funksionimit të Drejtorisë Rajonale Tirane e OSSH Sh.A, ku ky shërbim menaxhohet nga një strukturë e veçantë e specializuar prane kesaj drejtorie, do të përbënte një kosto të shtuar për institucionin tonë në ngritjen e strukturave të tjera, ç'ka do ta bënte të pamundur monitorimin e këtij shërbimi pasi do t'i shtoheshin kosto institucionit tonë ndarja ne lote.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor, vendosi të mos e ndajë në lote këtë procedurë prokurimi, pasi nëse një operator e fiton të gjithë kontratën, bazuar në parimin e ekonomisë së shkallës do mund të japi një ofertë ekonomike më të ulët dhe do mund të kursejmë të ardhura publike më shumë.

Për problemet që mund të lindin eventualisht gjatë zbatimit të kontratës, AK do i duhej të zgjidhte mosmarrëveshjet me dy ose më shumë operatorë dhe kjo mund ta vështirësonte zbatimin e kontratës.

Ka shumë vite që kjo procedurë realizohet e pa ndarë në lote, me të njëjtat institucione dhe vendroje që janë edhe këtë vit dhe shërbimet janë kryer me sukses, pa asnjë problem.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria Rajonale Tirane e OSSH sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë :

2.1 Kapaciteti profesional i operatoreve ekonomike

Drejtoria Rajonale Tiranë

- 2.1.1.** Operatori Ekonomik duhet të paraqese Licensën e Shoqërisë (te vlefshme) leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për ushtrimin e aktivitetit të Kategorisë “1.3.B”, konform Ligjit Nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me Ligjin Nr.10137 dt. 11.05.2009, Ligjit Nr.75/2014 “Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhëzimit Nr.130 dt. 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme “Për Funkcionimin e Sherbimit Privat të Sigurisë Fizike”.
- 2.1.2.** Operatori Ekonomik duhet të paraqese **Çertifikatën e Titullarit të Subjektit të Shoqërisë e cila duhet të jetë e vlefshme dhe t’i perkase ushtrimit të aktivitetit të Kategorisë “1.3.B”**, konform Ligjit Nr.75/2014 “Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhëzimit Nr.130 dt. 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme “Për Funkcionimin e Sherbimit Privat të Sigurisë Fizike”.
- 2.1.3.** Operatori Ekonomik duhet të paraqese **Çertifikatën e Drejtuesit Teknik të Shoqërisë e cila duhet të jetë e vlefshme dhe t’i perkase ushtrimit të aktivitetit të Kategorisë “1.3.B”**, konform Ligjit Nr.75/2014 “Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhëzimit Nr.130 dt. 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme “Për Funkcionimin e Sherbimit Privat të Sigurisë Fizike”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/b të Ligjit nr. 75 /2014 Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe në Kreun I, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislati në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

- 2.2.1** Operatori Ekonomik duhet të paraqese Kopje të certifikuar të bilanceve të tre viteve të fundit 2020, 2021, 2022 të konfirmuara me vule pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilet plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmasë “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Drejtoria Rajonale Tiranë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022, ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 200% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Drejtoria Rajonale Tiranë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku citohet:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:...b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: “Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”.

Ky kriter siguron që operatorët ekonomikë që marrin pjesë kanë kapacitetin financiar për të përmbushur detyrimet e kontratës në mënyrë të sigurtë dhe të efektshme. Ky është i rëndësishëm për të shmangur situata ku operatorët nuk plotesojnë kapacitetin financiar dhe nuk mund të përfundojnë me sukses kontratën.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2023 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Ky kriter të përmbushet nepermjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas Shtojcës Nr.9 të DST.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për

Drejtoria Rajonale Tiranë

Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar). Njësia e prokurimit kerkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti Teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës limit te kontrates qe prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Drejtoria Rajonale Tiranë

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Licensat profesionale lidhur me shërbimin objekt kontrate:

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të paraqese Autorizim Individual (*te vlefshem*) në emër të shoqërisë për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike (AKEP) konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ne te cilen te kete fushe mbulimi ne zonat ku ndodhen objektet ne qytetin e Tiranës dhe ku do kryhet shërbimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/c të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në pikën D. Qendra e Kontrollit, të Kreut VII, Uniformat, mjetet, pajisjet e shërbimit, dokumenti I identifikimit të punonjësve të SHPSF-SË, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme dhe në pikën 1, të Neni 65 Përdorimi i frekuencave, të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se: Personat fizikë apo juridikë mund të përdorin frekuencave vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht, me autorizim nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike (pajisjet e shërbimit) për të zbatuar kontratën.

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të disponojë një Qender Kontrolli të Shërbimit (Salle Operative) me adrese të përcaktuara sakte. Qendra e Kontrollit të jete e pajisur me sistem ndërlidhës, radiokomunikim dhe radioalarm, që të bëjnë të mundur sigurimin e pandërprerë të radiondërlidhjes pranë çdo objekti. Bazuar në nenin 22 të Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe në Kreun VII, pika 5 të Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funkcionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”; Operatori Ekonomik të paraqese akt miratimi të vlefshëm të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tirane. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të beje verifikimin në terren të ekzistencës së sallës operative.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Kreun VII, Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të Shpsf-së, pika D. Qendra e Kontrollit, të

Drejtoria Rajonale Tiranë

Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm, ku në pikën 5. Parashikohet: Miratimi i Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet nga drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, bazuar në vendimin e KSHKC-së, në çdo dy vjet, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në aktin e miratimit bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve. ***Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.***

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqese vertetim performance leshuar ne jo me pare se tre muaj nga hapja e procedures nga Drejtoria e Policise se Tirane per kategorine e Licences 1.3B konform ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) te ndryshuar si dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij. Ku duhet te jepet informacioni per disponimin e: Qendra e kontrollit te Sherbimeve (salle Operative)

- Numrin e punonjësve të shërbimit të certifikuar ku operatori ekonomik te kete jo me pak se 24 punonjes te certifikuar.
- Operatori Ekonomik te disponoje jo me pak se 24 arme te Kategorise 1.3 B, Nenkategoria B1 dhe B4 per kryerjen e sherbimit te kerkuar, nga te cilat te kete 12 arme brezi nenkategoria B1 dhe 12 arme krahu nenkategoria B4, per kryerjen e sherbimit te kerkuar.
- Operatori Ekonomik te kete te dhena te plota ne lidhje me mjetet speciale ne administrim, te nevojshme per te kryer ruajtjen dhe shoqerimin e vlerave monetare, ne zbatim te Ligjit Nr. 75/2014 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike” dhe Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshëm “Per Funkionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”. Mjetet speciale te perfshijne jo me pak se:
 - 24 radio nderlidhje
 - 24 shkopinj gome
 - 24 hekura lidhes
 - 24 jeleke antiplumb

Mjetet speciale mund te permbushen nga operatorët ekonomik ose ne vertetimin e policise ose nepermjet paraqitjes se faturave tatimore qe vertetojne blerjen e tyre por edhe te jene marre me qira.

- Operatori Ekonomik te mos kete shkelje te konstatuara dhe mase administrative te marre nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane per Subjektin, Titullar Subjekti dhe Drejtues Teknik nga data 1 janar 2022 e ne vazhdim.
- Vertetimi te permbaje vleresim permbledhes per performancen e Operatorit Ekonomik.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve pjesëmarrës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht KREU I, Procedurat për licencim, certifikim dhe ricertifikim të subjekteve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike, germa A. Të përgjithshme, pika 11.

Drejtoria Rajonale Tiranë

Certifikata e punonjësit të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike jepet sipas nënkategorisë së licencës dhe miratimi i saj është kompetencë e drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë, ku ka vendbanimin punonjësi i shërbimit, bazuar në vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim (KSHKC), të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

2.3.5. Operatori Ekonomik duhet të paraqese vertetim leshuar nga administrata tatimore për numrin e punonjesve të siguruar për 3 muajt e fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Ky dokumentacion të paraqitet i shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ku të jenë të pasqyruar të pakten 26 punonjes (përfshirë punonjesit e certifikuar dhe stafin drejtues) të paraqitura dhe të konfirmuara nepermjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesipërme. Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur Operatori Ekonomik shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nepermjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht referuar në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, germa C) Kategorizimi i automjeteve të blinduara dhe shoqëruese, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm, *duhen më shumë se një shoqërues për automjet, (12 autoblanda X 2 punonjes = 24 punonjes) duke përfshirë titullarin e shoqërisë, drejtuesin teknik, disponimi i një numri prej = 26 punonjësish të siguruar është numri minimal i kërkuar, për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.*

2.3.6. Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 12 automjete të blinduara në emer të shoqërisë ose me qera për transportin e vlerave monetare. Mjetet e blinduara duhet të jenë të pajisura me:

Drejtoria Rajonale Tiranë

- Autorizim te posacem vjetor nga Drejtori i Pergjithshem i Policise se Shtetit per perdorim te cdo mjeti te blinduar (te vlefshem), ku te jene percaktuar emri i shoqerise, te dhenat e mjetit dhe afati i vlefshmerise.
- Certificate pronesie.
- Leje qarkullimi nga Drejtoria e Transportit Rrugor per cdo mjet.
- Leje drejtimi te perdoruesit te mjetit te blinduar.
- Certificate e kontrollit teknik per secilin mjet (SGS).
- Siguracion te vlefshem.
- Vertetim per taksat e paguara.
- Marrja me qira ose huaperdorja e automjeteve te mesiperme, do te pranohet nese kontrata/t e qiramarrjes / huaperdorjes jane te lidhura para noterit, me afat vlefshmerie brenda afatit te zbatimit te kontrates per kete sherbim, te shoqeruara me dokumentacion (certificate pronesie, leje + qarkullimi, siguracion dhe akt kolaudimi te vlefshem). Ne rast te mjeteve ne perdorim apo me qera, ne autorizimin perkatës te Drejtorit te Pergjithshem te Policise se Shtetit te jete shënuar emri i perdoruesit apo qeramarresit. (Referuar Udhëzimit te Përbashkët te Ministrit të Brendshëm Nr. 1362/2 Prot date 29.05.2006 dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit me Nr.5495 Prot dt.31.05.2006 “Për karakteristikat konstruktive dhe funksionale të mjeteve të blinduara”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ç,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në pikën 1 të nenit 32 të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

2.3.7. Operatori Ekonomik duhet te kete 12 certifikata te leshuara nga prodhuesi i mjetit te blinduar per normen e blindimit ku te referohet se te gjitha automjetet e blinduara jane te Kategorise BR 6 sipas normes europiane EN 1063 dhe kategoria FB4+ per normen europiane EN 1522, ose me standarte te ngjashme me to, ne zbatim te Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshëm “Per Funkionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”, botuar ne Fletoren Zyrtare ne date 09.03.2018.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ç,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në pikën 1 të nenit 32 të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, germa C) Kategorizimi i automjeteve të blinduara dhe shoqëruese, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Konkretisht: Për vetë rendësinë që ka realizimi i këti lloji shërbimi me operatorë të licensuar, referuar specifikimeve teknike, numrit të prekjeve sipas qarqeve, vlerave të konsiderueshme që transportohen kryesisht nga bankat në drejtim të zyrave postare, si dhe shtrirjes në gjithë

Drejtoria Rajonale Tiranë

republikën, është përcaktuar edhe norma e blindimit për automjetet e blinduara që do të ofrojnë shërbimin objekt kontrate.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 2 (dy) kuti (valixhe) për mbajtjen e banknotave me boje ngjyrosje për perballimin e situatave të emergjencave. Për të vertetuar këto operator duhet të paraqesë faturen tatimore për blerjen dhe pagesën që verteton vlerën e blerjes ose deklaratën doganore të mallit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të beje verifikimin në terren të ekzistencës së valixheve për mbajtjen e banknotave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ç,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 37, Pajisjet e Shërbimit, të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në Kreu VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara Gjatë Transportit, gërma B. Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, pika 8. e Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë së Brendshme, ku parashikohet se: *Në kontratën ndërmjet palëve të përfshihet edhe kategoria e mjeteve të blinduara, sasia maksimale-minimale e vlerave monetare që do të transportohen gjatë një eskortimi, përdorimi i GPS-së, bojë ngjyrosje me kod për çdo bankë, kamerat e regjistrimit, sinjali SOS, radio komunikimi etj.*

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike bazuar në legjislacionin në fuqi për ruajtjen e vlerave monetare.

Fondi limit është llogaritur nga drejtoria qendrore Tirane

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë

Data 08.01.2024 Ora 10.00 vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit

NJËSIA E PROKURIMIT